



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Datë:	30.06.2026
Për/Za/To:	z. Faton Peci – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
Nga /Od /From:	Alban Fejzullahu - Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Mitrovicën e Jugut
Tema /Subjekti /Subject:	Raporti vjetor janar-qershor 2026



I nderuar,

Faton Peci – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme në kuadër të punëve të parapara sipas Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësit e organeve komunale, më kompetencë dhe përgjegjësi ka përgatitur raportin e punës janar-qershor 2026, bazuar në nevojat dhe kërkesat e institucionit.

Raporti i drejtorisë se Administratës Janar-Qershor 2026

Qendra për Shërbim me qytetarë (QSHQ)

01/01/2026 - 30/06/2026

Ne qendrën për shërbim me qytetar janë pranuar gjithësej 17106 dokumente

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Posht e	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DAP	Drejtoria për Administratë dhe Personel	14	945	2,662	0	0	0	0	7	20,194	23,822
DA	Drejtoria për Arsimit	8	974	268	12	0	0	0	6	0	1,268
DBZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1	21	18	1	0	0	0	0	0	41
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	22	484	2,510	27	0	0	2	10	0	3,055
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	73	31	14	0	0	0	3	0	121
DSE	Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia	4	174	7	92	0	0	0	1	0	278
DI	Drejtoria e Inspeksionit	6	305	14	1	0	0	1	6	0	333
DSH	Drejtoria për Shëndetësi	17	1,329	12	0	0	0	0	20	0	1,378
DSHPS	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë	2	261	66	87	0	1	0	3	0	420
DPU	Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit	0	546	37	6	0	0	1	14	0	604
DEZHTIE	Drejtoria për Ekonomik, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evopiane	4	93	8	0	0	0	0	0	0	105
Kryesia	Kryesia	0	280	956	2	0	0	0	20	0	1,268
AKNS	Asambleja Komunale	0	26	85	0	0	0	0	2	0	113
DMMP	Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve	0	8	13	0	0	0	0	0	0	21
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe pronesi	0	101	2,896	3	0	0	0	17	0	3,017
DMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	17	92	1,161	32	0	0	0	5	0	1,307
ZLKK	Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim	2	99	12	34	0	0	0	1	0	148
NJAB	Njësia për Auditim të Brendshëm	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
		97	5811	10767	311	0	4	4	115	20194	37,300

Poashtu janë vulosur qindra dokumente dhe shkresa të lëshuara nga Komuna e Mitrovices së jugut.

Sektori për punë të përbashkëta

R A P O R T

Raporti vjetor i punës, Janar-Qershor/2026

Në kuadër të punëve dhe detyrave të parapara sipas Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësit e organeve komunale, sektori për punë të përbashkëta me kompetenca dhe përgjegjësi ka realizuar pritshmëri dhe ka përmbushur detyrat e punës dhe përgjegjësit sipas fushave që mbulojnë njësit apo zyrat e këtij sektori.

Për periudhën që raportohet zyra për furnizim, është ballafaquar me pranimin e mallrave dhe shërbimeve duke kontaktuar me furnitorët për furnizim me artikuj me sasinë e porositur, cilësinë dhe vlerat e artikujve sipas kontratës për furnizim.

Kërkesa të realizuara264

Kërkesa për dorëzimin e mallit..... 263

Regjistrimi i lëndëve të njëjta në programin mbi menaxhimin e pasurisë.

Për kompletimin e lëndës deri te dorëzimi për pagesë, janë kryer veprimet si vijon:

- Kërkesa për blerje,
- Kërkesa për dorëzim,
- Pranimi i faturës sipas dërgesës së mallit dhe shërbimeve,
- Plotësimi i formularit për pranimin e mallit,
- Regjistrimi në librin e faturave hyrës,
- Kontimi i hyrjeve-dalje së mallit sipas programit e-pasuria

Zyra e verifikimit të dokumenteve;

Vërtetime për pensionist që janë në jetë për rregullimin e pensionit jashtë shtetit 56, lajmërimi 12, çlajmrimi i vendqëndrimit, certifikata të gjendjes ekonomike 0, Mbajtës i familjes 169, Dëshmi mbi vdekjen 68.

Gjithsejtë numri i lëndëve të kryera 315.

Shërbimi teknik;

Shtëpiaku-mirëmban objektin dhe hapësirat për rreth tij në baza ditore, ka sanu prishjet e shkaktuara në rrjetin e ujësjellësit, të kanalizimit, ka bërë pastrimin e pusetave, ka ndërhyrë në rrjetin elektrik, nxehja qendrore, mirëmbajtja dhe kontrollimi i tyre, riparime të vazhdueshme në nyjet

sanitare në objektin e komunës dhe në zyrat e vendit, riparimi i tavolinave , karrikave, dyerve dhe dritareve etj.

Fotokopjat: Shumzimi i materialit për shërbime të kuvendit dhe organeve të tjera të Komunës.

Bën mirëmbajtjen-pastrimin në kontinentet të fotokopjeve si dhe bën riparimin e prishjeve të vogla.

Shpërndarja e postes sipas destinacionit në adresa të përcaktuara nga dërguesi përmes librit të dërgesave, në kohën dhe vendin e duhur, duke u kujdesur në veçanti në ruajtjen e afateve ligjore.

Kamerat e vëzhgimit nuk janë në funksion, administrimi i aksesit në përcjelljen e zhvillimeve brenda dhe jashtë hapësirave të objektit të komunës, vëzhgimi i hyrje-daljeve është nën monitorimin e kompanisë për sigurimin fizik të objektit.

Sigurimi fizik i objektit dhe pasurisë të komunës, vëzhgimi i vazhdueshëm i hyrje – daljeve, regjistrimi në librin e kujdestarisë të çdo hyrje në objekt të personave pas orarit të punës.

Sektori i Gjendjes Civile

Raporti i gjendjes Civile nga data 01.01.2026 deri me 30.06.3026 gjithësej janë lëshuar 32580 dokumente

DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË BRENSHËM

#	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
1	Mitrovicë	1519	12739	19	2183	1943	886	412	2865	228	22794
	TOTALI	1519	12739	19	2183	1943	886	412	2865	228	22794

DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË JASHTËM

#	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
1	Mitrovicë	3934	2340	61	1461	253	789	292	478	178	9786
	TOTALI	3934	2340	61	1461	253	789	292	478	178	9786

Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Periudha e raportimit : Janar – Qershor 2026

Përgatitur nga: Zyrtarja për Barazi Gjinore

Data :30.06.2026

Ky raport paraqet aktivitetet dhe angazhimet e Zyrës për Barazi Gjinore, politikave komunale dhe strategjive institucionale për promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave dhe integrimin e perspektivës gjinore në punën e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Gjatë kësaj periudhe janë ndjekur këto objektiva :

Zbatimi i politikave për barazi gjinore në nivel lokal komunal.

Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe programet komunale.

Bashkëpunimi me drejtoritë komunale, institucionet qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile.

Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse.

Promovimi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.

Aktivitetet e realizuara

-Me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me organizatat CECD Friends, Mitrovica Women Association for Human, dhe Business Women Mitrovica, ka organizuar tryezën e diskutimit me temën:

“Barazia Gjinore në Nivel Lokal – Nga Politikat në Zbatim”

-Organizimi i marshit **“MARShojmë S’festojmë”**

-Shpërndarja e garantëve për gratë fermerë në bashkëpunim me FAO dhe UN-Women

-Trajnime për zyrtarët komunal

-Mbledhja dhe futja e të dhënave për performancën komunale

-Përgatitja e dokumenteve për thirrjen publike për subvencione

Bashkëpunimi institucional

-Bashkëpunimi me drejtoritë komunale

-Agjencinë për Barazi Gjinore

-Policinë e Kosovës

-Organizatat e shoqërisë civile lokale

-Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët

Trajnime dhe pjesëmarrje

-Pjesëmarrje në punëtorinë për integrimin e perspektivës gjinore në Nivel Lokal, organizuar nga FAO në bashkëpunim me zyrën për barazi gjinore.

-Pjesëmarrje tre ditore në punëtorinë e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali si dhe hartimin e planit të veprimit.

-Pjesëmarrje në punëtorinë për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2026-2035

-Pjesëmarrje në Forumin e parë rajonal të dedikuar sistemit të kujdesit në Kosovë, Regional Transform Care Forum 2026, organizuar nga Un-Women

Integrimi i perspektivës gjinore

Gjatë kësaj periudhe është kontribuar në :

- Dhënien e komenteve për dokumentet komunale
- Promovimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor
- Ofrimin e rekomandimeve për drejtoritë komunale
- Pjesëmarrje në grupet punuese komunale

Sfidat

Burime të kufizuara financiare

Nevoja për koordinim më të madh ndërinstitucional

Pjesëmarrje jo e mjaftueshme në disa aktivitete

Nevoja për më shumë trajnime për zyrtarët komunal

Rekomandimet

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional
- Lejimi i mjeteve buxhetore për realizimin e aktiviteteve
- Rritja e mbështetjes buxhetore për aktivitetet e barazisë gjinore
- Organizimi i trajnimeve periodike
- Përfshirja më e madhe e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse

Përfundim

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2026, zyra për Barazi Gjinore në komunën e Mitrovicës së Jugut ka realizuar disa nga aktivitetet e planifikuara në bashkëpunim me institucionet komunale, institucionet qendrore dhe organizatat partnere lokale dhe ndërkombëtare. Angazhimi ka qenë i fokusuar në promovimin e barazisë gjinore , fuqizimin e grave dhe vajzave, mbështetjen e grupeve të cënueshme dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe programet komunale. Në periudhën e 6 mujorit të dytë do të vazhdohet me aktivitetet e planifikuara dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Zyra e Teknologjisë Informative

Raport Pune – (Janar – Qershor 2026)

Zyra për Teknologji Informative punëve të përditshme ka si Monitorimi I dhomës së SERVER-ave, Sistemit të menaxhimit të palëve në Gjendjen Civile, Sistemin për menaxhim dhe arkivim të dokumenteve, sistemin e Intranetit, sistemin e vijueshmërisë në punë, e-arkivën, e-pasurinë, Sistemin e BDMS në financa etj.

Zyra për Teknologji Informative ka në menaxhim rrjetin në këto objekte : ATK, QKRC (te pasaportat), QRA (qendra e regjistrimit të automjeteve), DKRS, Enti I pensioneve, QPS, Mitrovica e veriut, Spitali regjional Mitrovicë, Shtëpia e shëndetit, E-kiosku Tunel i Parë, ZGJ Shupkovc, E-kiosku Shipol dhe, ZGJC Spital, Patentë shoferet stacion i autobusëve, Burgu Veri, QPT ne veri etj.

Janë krijuar llogari elektronike ne AD për zyrtar për shkolla dhe zyrtar te komunës dhe janë përditësuar shumë llogari elektronike për zyrtarët e QKMF-së për shkak se janë hapur qe tre vite dhe nuk janë përdorur asnjëherë dhe për zyrtarë tjerë.

Është mirëmbajtur sistemi i radhës në QSHQ dhe Gjendje Civile, është krijuar share follderit dhe janë duke u krijuar çasje për secilin zyrtar ku do të ketë shënimet e veta edhe skanimet.

Zyra e Teknologjisë Informative intervenimet primare I ka tek zyrtarët që kanë të bëjnë më palë si Gjendja Civile, QSHQ, Tatimi në Pronë, ARKA dhe Kadastrin, për vitin 2026 ka kryer mbi 850 intervenime duke përfshirë edhe përkrahjen e qytetarëve ne platformën eKosova.

DREJTORI I ADMINISTRATËS SE PERGJITHSHME ,
ALBAN FEJZULLAHU

